



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Datë 11/11/2024

PROCES VERBAL

Konsultimi për Buxhetin dhe Paketën Fiskale 2025

Vendi : Njësia Administrative Petran

Ora : 11:00

Tema e konsultimit : Buxheti dhe Paketa Fiskale 2025.

I mbajtur sot më datë 11 Nëntor me pjesëmarrjen e Kryetares së Bashkisë, znj. Alma Hoxha, nën/Kryetarit z. Florand Hasani, Kryetarit të Komisionit të Ekonomisë z. Agathokli Proko.

Pjesëmarrës janë Kryetarët e Fshatrave të Njesisë Administrative Petran dhe banorë të zonës. Takimin e hapi znj. Alma Hoxha e cila si fillim falenderoi të gjithë të pranishmit. Më pas ajo u tha se këto takime janë mjaft të rëndësishme për të hartuar buxhetin si dhe për tu njohur akoma më shumë me problematikat e zonës. Në vijim të fjalës znj. Hoxha u tregoi të pranishmëve disa nga investimet që do të kryhen në këtë zonë ku më të rëndësishmet veçoi Ujësjetësin e Petranit, Rrugën e Leusës dhe disa investime në fshatin Bënjë dhe në pjesën e Ujërave Termale.

Problematikat që Kryetarët e Fshatrave paraqitën janë si më poshtë :

Fshati Lëshicë

1. Rruga e fshatit ka nevojë për ndërhyrje
2. Ndërhyrje në kanalizimet e fshatit
3. Caktimi i një vendgrumbullimi për mbetjet

Fshati Badlonjë

1. Problemi me rrethimin e varrezave
2. Ndërhyrje tek Rruga e Malit të Bardhë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Fshati Bodar

1. Rruga e varrezave dhe hyrja
2. Rrugët që të cojnë në parcelat e fshatit

Fshati Lipë

1. Përmirësimi i pastrimit të fshatit
2. Riparim i kunetave të rrugëve
3. Ndërhyrje te gropa septike e fshatit

Fshati Kaludh

1. Kanali kullues i fshatit me probleme
2. Rrugët që të cojnë në parcelat e fshatit

Në fund të këtij takimi znj. Alma Hoxha u tha banorëve se së bashku me stafin e saj do të fillojë menjëherë nga puna për të ndërhyrë sa më shumë të jetë e mundur. Duke i falenderuar për bashkëpunimin e mirë që ekziston ndër vite mes palëve, znj. Alma Hoxha u shpreh e gatshme për të diskutuar gjithmonë kur bëhet fjalë për të mirën e përbashkët të komunitetit.

Konceptoi:

Koordinatori i Konsultimit Publik

Albion Naska

SEKRETARI PËRGJITHSHËM

Denisa DURO

Foto nga takimi:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

